



Република Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ
Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT
O M B U D S M A N
Republic of Macedonia

Avokati i Populli – Mekanizmi Parandalues Nacional (MPN) më datë 21-22.11.2017 realizoi vizitë në Spitalin Psikiatrik Negorc. Vizita u realizua në kuadër të mandatit dhe kompetencave të cilat burojnë nga Protokollin Fakultativ ndaj Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Jonjerezore, Nënçmuese dhe Ndëshkuese dhe Ligji i Avokatit të Popullit.

Mekanizmi Parandalues Nacional vizitën në Spitalin Psikiatrik Negorci e realizoi në disa hapa, në përputhje me Rregulloren dhe Metodologjinë për zbatimin e parandalimit nga tortura dhe llojet e tjera të trajtimit brutal, jonjerezor, nënçmues ose ndëshkues.

Ekipi i MPN potencoi se asnjë organ i pushtetit dhe as funksionar nuk do të urdhëroj, zbatoj ose toleroj kurrfarë sanksionesh kundër cilido person ose organizatë për dhënien e informatave të këtylla drejtuar Mekanizmit Parandalues Nacional, pavarësisht nëse të njëjtat janë të rreme ose të vërteta, dhe asnjë person ose organizatë e tillë nuk do të dëmtohet konform Protokollit Fakultativ ndaj Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Jonjerezore, Nënçmuese dhe Ndëshkuese.

Ekipi i MPN-së hasi në bashkëpunim të mirë me personat zyrtarë të Spitalit Psikiatrik të Negorcit, të cilët mundësuan qasje papengesë deri te të gjitha hapësirat dhe instalimet dhe këqyrje mbi dokumentacionin e kërkuar.

E drejta e respektimit të personit, dinjitetit dhe privatësisë së personave me sëmundje mendore, e drejta e mbrojtjes nga çdo formë e keqtrajtim, përçmimit dhe abuzimit, e drejta e sigurimit human dhe jetësor të mjedisit, janë vetëm një pjesë e të drejtave të përgjithshme të personave me sëmundje mendore, të përcaktuara në Ligjin për shëndet mendor. Në këtë drejtim, ekipi i MPN-së konstatoi se pacientët e reparteve nuk vishen me pizhame, por me veshmbathje ditore, e që e vë në dukje respektin dhe dinjitetin e tyre gjatë qëndrimit në institucion.

Së këtejmi, ekipi i MPN-së u informua se është ndërprerë praktika e larjes grupore të pacientëve, por për shkak të mungesës së personelit përkatës, ende praktikohet larja e pacientëve nga ana e personave zyrtarë, përkatësisht personelit, të cilët janë të gjinisë së kundërt. MPN-ja rekomandon ndërprerjen e praktikës së këtyllë, për shkak se me trajtimin e këtyllë rrezikohet privatësia e pacientëve.

Ekipi i Mekanizmit Parandalues Nacional gjatë kohës së vizitës realizoi më shumë biseda individuale me një pjesë të pacientëve të vendosur në Spitalin Psikiatrik Negorci dhe me personat zyrtarë, në kontekst të trajtimit dhe shkallës së realizimit të të drejtave të tyre.

Nga bisedat e zhvilluara me pacientët, Ekipi i MPN-së konstatoi se në përgjithësi ata janë të kënaqur nga sjellja e personelit. Megjithatë, një pjesë e pacientëve u ankuan për sjelljen e një personi zyrtar të personelit spitalor, për çka u bisedua edhe me drejtoreshën e institucionit, e cila theksoi se me personin përkatës do të zhvillohet bisedë lidhur me ankesat e paraqitura.

Gjithashtu, Ekipi i MPN-së u informua se nuk ka pasur incidente të dukshme midis pacientëve dhe se në përgjithësi atmosfera në reparte është kryesisht e relaksuar dhe e qetë.

Gjatë vizitës së realizuar, Ekipi i MPN-së vuri në dukje se kushtet për jetesë në spital janë të njëjta në të gjitha repartet. Përkatësisht, pjesët e spitalit të cilët janë rinovuar sigurojnë kushte adekuate për vendosje, ndërsa pjesët të cilat nuk janë rinovuar janë gjendje alarmante.

Duke e pasur parasysh se kushtet në hapësirat e qëndrimit ditor dhe aktivitetet okupuese të reparteve, të cilët nuk janë rinovuar janë të pakënaqshme, sa i përket pajisjes dhe mirëmbajtjes së tyre, MPN-ja rekomandon angazhim shtesë nga ana e personave zyrtarë të Institucionit, në drejtim të sigurimit të mjedisit human dhe të sigurt jetësor.

E drejta e informimit të pacientëve, të vendosur në spitalet psikiatrikë, nënkupton mundësi për pacientin që në të gjitha fazat e mbrojtjes shëndetësore të njoftohet plotësisht me gjendjen e tij shëndetësore, për rrjedhën e procedurës gjatë ofrimit të ndihmës shëndetësore, për mundësinë e vendosjes për intervenimet e rekomanduara mjekësore, për rekomandimin e mënyrës së jetesës, për të drejtat e mbrojtjes shëndetësore dhe sigurimit shëndetësor, për procedurën e realizimit të këtyre të drejtave dhe ngjashëm¹.

Nga bisedat e zhvilluara me pacientët e vendosur në këtë institucion, Ekipi i MPN-së konstatoi se një pjesë e pacientëve janë të ndërgjegjshëm për terapinë që e pranojnë, megjithatë, tek ata mungon informimi real për të drejtat e tyre të garantuara me Ligjin për shëndet mendor.

Ekipi i MPN-së vuri në dukje se pacientët angazhohen në aspekt të zbatimit të aktiviteteve të përditshme higjienike, në kuptimin e rregullimit të krevateve, mirëmbajtjes së higjienës në hapësirat në të cilat janë vendosur, megjithatë, Ekipi i MPN-së rekomandoi animimin e rregullt të pacientëve, në mënyrë që të përmirësohen shprehitë e tyre jetësore.

Pacientët e këtij spitali nuk i kanë ditët e strukturuar, ata nuk kanë aktivitete ditore, si dhe të nuk motivohen për të marrë pjesë në ndonjë lloj aktiviteteve. Pacientët kanë qasje në Qendrën për terapinë e punës, të cilën pothuajse nuk e vizitojnë fare, qasje deri në hapësirën për ushtrime, e cila në të shumtën e rasteve është e mbyllur, ndërsa spitali disponon edhe me bibliotekë, e cila gjendet në ndërtesën administrative, por pacientët nuk kanë qasje të drejtpërdrejtë deri te e njëjta.

Sipas informatave, të cilat i siguroi Ekipi i MPN-së, pacientët nuk kanë ankesa sa i përket shfrytëzimit të të drejtës për kontakt me të afërmit e tyre, personalisht ose përmes telefonit, si dhe të pranojnë dërgesa.

Së këtejmi, personat nga Reparti për trajtimin e alkoolizmit dhe varësive e çrregullimeve të tjera jo-psikotike mund të largohen nga spitali nën kushte të caktuara. Konkretisht, mund të pranojnë vizita në përputhje me Rendin e shtëpisë, mund të marrin pjesë në aktivitete në bashkësi jashtë Shtëpisë dhe të informohen për ngjarjet jashtë ambienteve të spitalit nga bashkësia për të cilët ata manifestojnë interesim.

¹Neni 7 i Ligji për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve

Nga këqyrja në hapësirat e vendosjes, MPN-ja vuri në dukje se numri më i madh i dhomave në spital kanë hapësira për ruajtjen e sendeve më të domosdoshme personale të pacientëve. Gjithashtu, nga bisedat e zhvilluara me pacientët, u njoftuam se nuk kanë kurrfarë kufizimesh, në aspekt të posedimit të sendeve për përdorim personal. Së këtejmi, MPN-ja konstatoi se kjo e drejtë e pacientëve në Spitalin Psikiatrik Negorci është realizuar tërësisht.

Nga ana e personave zyrtarë, Ekipi i MPN-së u informua se ushqimi në spital është i mirë, i shumëllojshëm dhe i mjaftueshëm sa i përket sasisë. Megjithatë, një numër i madh i pacientëve u ankuan për mungesën e perimeve në ushqim. Gjithashtu, Ekipi i MPN-së, në ditën e vizitës, vërejti se ushqimi që u servohet pacientëve nuk korrespondonte me ushqimin i cili ishte parashikuar me menynë për atë ditë. Duke e pasur parasysh se menyja e ushqimit bëhet me konsultimin e personit profesionist, me qëllim që të sigurohet ushqim me vlera të nevojshme ushqyese.

Kufizimet fizike – fiksimi bëhet në dy hapësira për fiksime, njëri është në repartin akut të meshkujve dhe përdoret ekskluzivisht për pacientët meshkuj, ndërsa hapësira tjetër është në repartin akut të femrave dhe përdoret për pacientet femra. Në hapësira ka nga tre krevate, ndërsa njëri nga krevatet, i cili nuk është i përfunduar për dysheme, ka rripa jostandarde për fiksime rreth gjoksit dhe duarve. Në hapësira nuk ka veshje të buta të mureve për mbrojtje, ndërsa rripat janë nga materiali i cili mund të shkaktoj lëndime tek pacientët, e që u theksua nga personeli mjekësor i spitalit. Për këto shkaqe, shpeshherë, në mënyrë që të zbatohet kufizimi fizik, në vend të rripave, personeli përdor fasha të gjera. Shqetëson fakti se gjatë kohës së fiksimit, në hapësirë qëndrojnë edhe persona të tjerë të cilët janë dëshmitarë të intervenimit mbi pacientët.

Duke e marrë parasysh këtë që u tha më lartë, MPN-ja rekomandon përshtatje urgjente të hapësirave për fiksime, të cilat do të pajisen në mënyrë adekuate për këtë qëllim dhe të cilat do të mundësojnë edhe kufizim të sigurt dhe papengësë të pacientëve për të cilët një gjë e këtillë është e domosdoshme.

Si rezultat i vizitës së realizuar, Mekanizmi Parandalues Nacional përpiloi raport të posaçëm, në të cilin i konstatoi gjendjet dhe dha rekomandime përkatëse të cilat ia dërgoi Ministrisë së Shëndetësisë dhe drejtorit të spitalit psikiatrik, me qëllim të eliminimit të rreziqeve dhe mangësive.